

Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS
PLANI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2024

Trusti

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS
KOSOVO PENSION SAVINGS TRUST
KOSOVSKI PENZIJSKI ŠTEDNI FOND

PËRGATITUR:

Prishtinë, tetor 2023

Kontakt:

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 Prishtinë
www.trusti.org || info@trusti.org || 038-600-020

PËRMBAJTJA

1.

HYRJE

2.

MANDATI

3.

FUNKSIONET
DHE PËRGJEGJËSITË

4.

AKTIVITETET

5.

AVANCIMI I
PROCESEVE

6.

PLANI I VEPRIMIT
PËR 2024

7.

PROJEKSIONI DHE
PLANI I TË HYRAVE
PËR 2024

AKRONIME

FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
ATK – Administrata Tatimore e Kosovës
Qeveria – Qeveria e Republikës së Kosovës
Kuvendi – Kuvendi i Republikës së Kosovës
BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Bordi – Bordi Drejtues i FKPK-së
MNM – Mjetet Neto nën Menaxhim

1. HYRJE

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur dhe jo-për-profit, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. FKPK-ja është projektuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, ashtu që secilit kontributdhënës i hapet llogari personale e kursimeve pensionale në këtë institucion. Në llogari ruhen të gjithë informacionet dhe përmes saj kryhen të gjitha transaksionet hyrëse, investuese dhe dalëse.

FKPK-ja është themeluar në dhjetor të vitit 2001 dhe ka filluar aktivitetin në gusht të vitit 2002 – për të administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

Aktivitetin e përgjithshëm të FKPK-së e rregullon Kuvendi i Kosovës, ndërsa mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë e realizon Banka Qendrore e Kosovës (BQK). FKPK-ja është e angazhuar kryekëput për mbajtjen në mirëbesim dhe investimin e kontributeve pensionale të kursyera nga qytetarët e Kosovës gjatë marrëdhënies së punës.

Administrimi i llogarive individuale është përgjegjësi ligjore, megjithatë paratë e kursyera mbesin pronë vetanake e kontribuuesve. Edhe pse pronë vetanake, mandati i këtyre kursimeve është specifik: ato mund të përdoren vetëm për pension – dhe nuk mund të përdoren për asnjë arsye e as të tërhiqen përpara moshës së pensionimit (p.sh nuk mund të merren për hua, për trajtime mjekësore e të ngjashme).

Institucioni, tashmë 22 vjet pas themelimit, ka një përvojë të dëshmuar të administrimit dhe menaxhimit në mirëbesim të kursimeve pensionale, duke ua ruajtur dhe shtuar vlerën e mjeteve pensionale përmes investimeve të matura.

Ndërsa mjetet nën menaxhim tashmë kanë arritur në 2.6 miliardë euro, dhe numri i llogarive të përgjithshme mbi 800 mijë, institucioni vazhdon të operojë me 30 anëtarë të përhershëm të stafit dhe me zyrën e vetme në Prishtinë.

FKPK-ja ngrihet mbi dy shtyllat kryesore në operim: atë të investimeve dhe tjetrën të operacioneve. Që të dyja gërshetojnë planet e veprimit si në rrafshin strategjik ashtu edhe atë operativ, për të përmbushur obligimet ligjore por edhe shërbyer më së miri nevojave të kontribuuesve.

Historikisht, prej themelimit, Kuvendi e ka mbikëqyrur FKPK-në përmes raporteve vjetore, ku përfshihen edhe pasqyrat e audituara financiare; si dhe përmes diskutimit e miratimit të tarifave menaxhuese, ku përfshihet edhe plani financiar për vitin e ardhshëm. Nëse ka nevojë, Kuvendi përmes komisioneve funksionale, gjithashtu realizon takime të jashtëzakonshme informuese me përfaqësuesit e FKPK-së. Në këtë mënyrë Kuvendit i është dhënë hapësirë për vlerësimin e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së institucionit.

Ky plan i performancës, i dedikuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës, synon të kristalizojë informacione të ndryshme dhe kryesore të planifikimit njëvjeçar të institucionit, për t'i ndihmuar anëtarëve të Kuvendit të mbikëqyrin, përcjellin e paraprijnë planifikimit afatshkurtër të institucionit.

Andaj përveç aktiviteteve të pritshme vjetore, këtij plani i bashkëngjitet edhe planifikimi i tarifave dhe të hyrave financiare për vitin e ardhshëm.

2. MANDATI

Mandati ligjor i FKPK-së është për administrimin dhe menaxhimin e kursimeve pensionale deri në pensionimin e kontribuuesve. Këto përgjegjësi janë për investimin e mjeteve pensionale, sipas parimeve që burojnë nga legjisllacioni në fuqi, si dhe ofrimin e shërbimeve për kontribuuesit deri në pensionim.

Investimet bëhen nga Bordi Drejtues i FKPK-së, me qëllim që kontributdhënësve t'u rritet vlera e kursimeve pensionale, dhe që në afatgjatë t'u mundësohet një ruajtje e vlerës së atyre mjeteve për pension.

Për këtë arsye, Bordi Drejtues i FKPK-së e ka përcaktuar si vlerë krahasimore (*benchmark*) mbulimin e inflacionit në Kosovë, gjithnjë duke e pasur parasysh jetëgjatësinë e investimeve të fondeve pensionale të akumuluar.

Investimet e mjeteve pensionale bëhen në klasa të ndryshme investuese, me shpërndarje të gjerë gjeografike (botërore dhe në Kosovë) dhe industri të shumta, në mënyrë që të shpërndahet (dhe kështu edhe zvogëlohet) rreziku i mundshëm nga investimet, sikurse vlerësohet e arsyeshme nga Bordi Drejtues.

Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë, së bashku me amandamentimet e tij, ia jep FKPK-së (pra përmes Bordit Drejtues), kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale (Neni 5.1), dhe i përcakton atij të drejtat lidhur me fondet pensionale duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në (Neni 5.2), duke përcaktuar:

- Udhëheqjen e tenderit për përzgjedhjen e menaxhues-it/ëve të mjeteve dhe mbajtësit të mjeteve ose instrumenteve për investime të hapura në pajtim me ligjet në fuqi.
- Zbatimin e marrëveshjeve me menaxhues-in/it e mjeteve, mbajtësit e instrumenteve për investime të hapura, llogaritarët, revizorët, avokatët dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për FKPK-në.

- Kërkimin dhe pranimin e informacionit nga drejtorët e mjeteve të instrumenteve për investime të hapura, nga mbajtësit e mjeteve dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të FKPK-së, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që FKPK-ja i mban.

- Miratimin e parimeve të investimeve për FKPK-në.

- Shkarkimin dhe zëvendësimin e drejtorit të mjeteve të instrumenteve për investime të hapura, mbajtësve të mjeteve dhe kryerësve të tjerë të shërbimeve të FKPK-së.

- Pagimin e fitimeve të llogarive individuale për pensionet e kursyera siguruesve të anuiteteve me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit në përputhje me këtë ligj.

- Lidhjen e marrëveshjeve për blerjen, shitjen, dhënie ose marrjen me qira të patundshmërive apo pajisjeve të nevojshme për funksionimin e FKPK-së.

- Punësimin e personelit ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv.

- Lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve, duke përfshirë edhe sigurimin fiduciar për anëtarët e Bordit Drejtues, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

- Përgatitjen e buxhetit vjetor (për investime dhe operacione).

- Caktimin e tarifave të arsyeshme, të bazuara në shpenzime, ndaj llogarisë së çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale - të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në baza vjetore.

- FKPK-ja e ka zyrën e saj kryesore dhe të vetme në Prishtinë. Porse shërbime për kontribuuesit dhe përfituesit e kursimeve për pension kryhen edhe në gjashtë qendrat e tjera të Administratës Tatimore të Kosovës në: Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan, përmes zyrtarëve pensionalë, të cilët janë staf i ATK-së.

3. FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË

FKPK-ja i ka të punësuar 30 profesionistë me kontrata të përhershme, funksioni i të cilëve është t'i pranojnë dhe t'i procesojnë kontributet nga punonjësit dhe punëdhënësit, dhe t'u ofrojnë këshilla dhe përkrahje teknike të gjithë kontribuuesve dhe palëve të interesit.

Funksionimin e saj FKPK-ja e ka të ndarë nëpër shtatë njësitë kryesore: marrëdhënie me klientë, financa, marrëdhënie me publik dhe trajnime, burime njerëzore, teknologji informative, çështjet ligjore dhe auditori i brendshëm.

Struktura institucionale është e dizajnuar për t'i menaxhuar me efikasitet llogaritë personale, për t'i mbajtur shënimet e kontributeve, ofruar një spektër të gjerë të shërbimeve për klientë dhe informuar publikun për çështjet e implementimit të programit pensional.

Punëdhënësit e deklarojnë obligimin për pagesë të kontributeve pensionale përmes sistemit online të deklarimit në ATK. Deklarimi bëhet përmes ngarkimit të listës së të punësuarve në sistemin e deklarimit online (EDI). Pas deklarimit, EDI i prodhon fletëpagesat përkatëse, përmes të cilave bëhet pagesa në cilëndo prej bankave komerciale ose institucioneve të licencuara për pagesa të tilla.

Nëse të punësuarit janë identifikuar saktë në listën e deklaruar në sistem, dhe nëse pagesa është bërë në përputhje me rregullat, zakonisht për tri deri në pesë ditë pune kontributet pensionale kalohen në llogaritë individuale të kursimeve pensionale në FKPK.

Kontributet e mbledhura investohen në tregjet globale financiare, që pritet të rriten në vlerë, ndërkaq kthimi nga investimet shpërndahet proporcionalisht nëpër llogaritë individuale.

FKPK-ja ngarkon tarifa mbi mjetet pensionale për t'i ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e saj.

3.1 Bordi Drejtues

FKPK-ja udhëhiqet nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga tetë anëtarë: pesë anëtarë profesionalë me përvojë së paku 10-vjeçare në lëmin e pensioneve ose investimeve; dy anëtarë përfaqësues (njëri i punëdhënësve dhe tjetri i të punësuarve); si dhe një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës, pa të drejtë vote.

Të gjithë anëtarët e Bordit (me të drejtë vote) emërohen nga Kuvendi i Kosovës me mandat katërvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes. Nëse mandati i anëtarëve të Bordit skadon dhe anëtarët e rinj nuk janë emëruar, atëherë anëtarëve ekzistues të Bordit iu vazhdohet mandati njëherë për nëntëdhjetë ditë.

3.2 Administrata

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorë: njëri për Financa, Investime e Risk dhe TI e tjetri për Operacione dhe Burime Njerëzore. Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe moralisht të shëndoshë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të madh, mjedis të përshtatshëm për punë, dhe përfundimisht, në shërbime më të mira për kontribuuesit - por edhe (kryesorja) në ruajtjen e integritetit institucional të FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi dhe Menaxhmenti, sigurojnë që Administrata aktuale vazhdon t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën, vazhdon të jetë e motivuar, dhe vazhdon të vë në funksion të gjitha kapacitetet mendore dhe profesionale në shërbim të avancimit të proceseve të brendshme dhe shërbimeve për klientë.

Administrata është e ndarë nëpër këto njësi funksionale, për të siguruar kështu efektivitet dhe efikasitet në punë.



4. AKTIVITETET

Aktivitetet e FKPK-së fillojnë nga pranimitë e kontributeve pensionale prej ATK-së, përmes konfirmimit dhe barazimit të atyre kontributeve nëpër llogaritë individuale në FKPK. Në rast të mosbarazimit (ose mungesës së raporteve të nevojshme), stafi i FKPK-së koordinohet me stafin e ATK-së, por edhe me punëdhënësit përkatës, për t'i gjetur informacionet e për t'i barazuar kontributet e paguara pensionale nëpër llogaritë individuale të kontribuuesve.

Njëkohësisht, bashkë me mjetet dërgohet edhe informacioni për secilin kontribuues në sistemin kryesor për menaxhimin e llogarive të FKPK-së, e po ashtu tek llogaritë e kontribuuesve, që e kanë aktivizuar shërbimin eTrusti.

Mjetet e pabarazuara, ose që nuk janë kontribute, kthehen në ATK, sipas legjislacionit në fuqi.

Investimi i mjeteve nën menaxhim është aktiviteti tjetër, ndër më të rëndësishmit, i institucionit. Vendimet për investimet janë ekskluzivisht e drejtë e Bordit Drejtues, sikurse parashihet në ligj, por anëtarët e Bordit ndihmohen në procesin e vendimmarrjes nga Menaxhmenti dhe stafi tjetër profesional i FKPK-së - përmes të dhënave, analizave e informacione specifike.

Procesi i investimit të mjeteve, ashtu sikurse ai i tërheqjes, kërkon një sërë veprimesh vendimmarrëse e administrative deri në realizim. Shumica e mjeteve nën menaxhim vazhdojnë të investohen jashtë vendit, meqë ende nuk ka mundësi të mjaftueshme (në harmoni me ligjin) për t'i investuar ato më shumë në Kosovë. Megjithatë FKPK-ja vazhdimisht shpreh interesimin për më shumë investime të mjeteve në vend.

Hallka e tretë e aktiviteteve kryesore të institucionit është procesimi i pagesave nga llogaritë e pensionuara në FKPK drejt bankave përkatëse në Kosovë. Kuptohet se përveç pranimit të kërkesave për pensionim, dhe realizimit të pagesave përkatëse, ka veprime që merren si për përgatitjen e marrëveshjeve me bankat, për tërheqjet në faza të pensioneve (kjo për bilancet e kursimeve pensionale mbi 3 mijë euro), ashtu edhe pas aplikimit për pension, sa herë ka kërkesa për informim e

ndihmë ndaj kontribuuesve.

Përveç këtyre aktiviteteve, institucioni ka përgjegjësi ditore në mirëmbajtjen e sistemit për përditësimin e të dhënave të të gjithë kontribuuesve, sigurinë dhe ruajtjen e atyre të dhënave, ofrimin e shërbimeve ditore, raportimin e vazhdueshëm, komunikimin dhe informimin pa ndërprerje dhe përgjigjen ndaj të gjitha kërkesave të palëve të treta (institucioneve, mediave, OJQ-ve, studentëve apo edhe individëve).

Qysh prej themelimit FKPK-ja i ka kushtuar një vëmendje të rëndësishme transparencës. Andaj, përveç raportimit të rregullt institucional, çdo informacion i rëndësishëm publikohet në uebfaqen e FKPK-së. Gjithashtu, në këtë frymë, institucioni prej 17 vjetësh ka filluar ta ofrojë shërbimin e qasjes në llogarinë e kursimeve pensionale përmes internetit (në portalin eTrusti). Tashmë janë mbi 325 mijë kontribuues që e përdorin këtë shërbim.

Përgjithësisht institucioni ka pasur si objektiv përdorimin sa më të madh të proceseve dhe shërbimeve digjitale, të bazuara në internet, si mënyrë më praktike dhe me kosto më të ulët. Por assesi këto vendime nuk janë marrë pa e analizuar riskun e mundshëm të sigurisë së të dhënave digjitale. Andaj FKPK-ja i përdorë teknologjitë më të fundit të shërbimit digjital që ofrohen dhe me standardet më të larta të sigurisë.

Fushëveprimtaria e FKPK-së mbikëqyret në baza ditore nga Auditori i Brendshëm i FKPK-së, ndërsa në baza gjastëmujore dhe vjetore nga Auditori i Jashtëm dhe Banka Qendrore e Kosovës.

Njëkohësisht, institucioni i raporton dhe mbikëqyret nga Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrje Financiare por edhe nga vetë Kuvendi, përmes shqyrtimit të tarifave vjetore të menaxhimit dhe diskutimit e miratimit të raporteve vjetore.

4.1 ARKËTIMI I KONTRIBUTEVE PENSIONALE

Arkëtimi i kontributeve pensionale dhe i raporteve përkatëse është detyrë e ATK-së. Megjithatë, FKPK-ja bashkëpunon ngushtë me ATK-në por edhe punëdhënësit individualisht, që të dhënat e kontributeve pensionale të jenë të sakta e të plota.

Numri dhe vlera e kontributeve pensionale ka vazhduar të ketë trend të ngritjes prej themelimit. Kjo ndodh, kryesisht, për shkak të vetëdijësimit të të punësuarve për rëndësinë e kursimeve pensionale, por edhe ngritjen (në vazhdimësi) të mbikëqyrjes dhe kontrollit nga ATK-ja.


Numri i kontribuuesve aktivë dhe vlera e kontributeve pensionale 2018-2022

Periudha	Numri i kontribuuesve aktivë në fundviti	Numri i llogarive të reja gjatë vitit	Vlera e kontributeve të reja për vitin
2018	344,453	35,121	€173,852,170
2019	379,827	43,286	€186,612,628
2020	387,526	37,437	€194,364,329
2021	419,657	45,290	€213,450,809
2022	428,891	40,409	€241,462,429

Numri i kontribuuesve aktivë dhe vlera e kontributeve sipas muajve më 2023

Periudha	Numri i kontribuuesve aktivë në fundmuaj	Numri i llogarive të reja gjatë muajit	Vlera e kontributeve të reja
Janar	433,932	2,293	€23,610,311
Shkurt	308,377	2,704	€20,839,113
Mars	331,276	2,742	€21,708,483
Prill	364,648	3,771	€23,526,237
Maj	377,644	3,439	€22,605,909
Qershor	388,993	3,685	€22,364,230
Korrik	400,921	4,141	€30,210,046
Gusht	412,051	4,825	€22,981,460
Shtator	420,008	3,386	€24,490,021

Në tabelën vijuese paraqiten të dhënat për shumën dhe numrin e kontribuuesve në pesë vjetët e fundit por edhe sipas muajve për vitin 2023.



4.2 INVESTIMI I MJETEVE PENSIONALE

FKPK-ja i investon mjetet nën menaxhim sipas legjislacionit në fuqi dhe në harmoni me Manualin e Investimeve të FKPK-së – një dokument po ashtu i bazuar në Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës. Investimet e FKPK-së duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe në veçanti me politikën e investimeve të matura e me këto parime investuese: 1) Sigurinë e mjeteve pensionale; 2) Diversifikimin e investimeve; 3) Kthimin maksimal në raport me sigurinë e mjeteve pensionale; dhe 4) Mbatjen e likuiditetit të mjaftueshëm.

FKPK-ja synon t'i përdorë edhe instrumentet e avancuara financiare, që zhvillohen në tregjet globale financiare, por edhe mundësitë maksimale për investime në Kosovë, gjithnjë duke ndërmarrë risk të arsyeshëm investues. Strategjitë kryesore që do të vihen në funksion për të arritur tek avancimi i investimeve janë:

- Rritja e vazhdueshme e plasmaneve direkte si përqindje e MNM;
- Rritja e mekanizmave monitorues të riskut dhe menaxhimi sa më aktiv i riskut.

Bordi Drejtues, si minimum krahasimor (*benchmark*) të performancës investuese, për Portofolin Standard, e ka përcaktuar mbulimin e inflacionit në Kosovë. Për shkak të inflacionit shumë të lartë më 2022, që arriti rreth 11%, norma e inflacionit në Kosovë e ka tejkaluar për rreth 4 pikë përqindjeje nivelin historik të ngritjes së çmimit të njësisë së FKPK-së (për periudhën prej themelimit e deri më 30.09.2023).

Manuali i investimeve dhe strategjia investuese përditësohen së paku një herë në vit, por edhe rishqyrtohen në çdo takim të Komisionit për Investime dhe Bordit Drejtues. Të njëjtat janë të publikuara në uebfaqen e FKPK-së dhe mund të gjenden në linkun: https://www.trusti.org/wp-content/uploads/2023/02/SIP_20230101_sh.pdf

4.2.1 Qëllimi i investimeve

Mjetet do të investohen vetëm në harmoni me dispozitat e Ligjit, me qëllim të maksimizimit të kthimit nga investimet, dhe vetëm-e-vetëm në të mirë të kontribuuesve dhe përfituesve të pensionit. Qëllimi i investimeve është gjithnjë në funksion dhe në përmbushje të katër parimeve investuese.

Bordi Drejtues beson se vendosja e normës së inflacionit si cak për t'u arritur dhe tejkaluar do të jetë kyç për ta mbajtur vëmendjen tek ruajtja e vlerës reale të kontributeve në Portofolin Standard.

Për të arritur synimin e Bordit Drejtues, përmes Udhëzuesit të Politikës së Investimeve, do të sigurohen:

- Procese dhe politika investuese efektive dhe efikase;
- Një qasje rigoroze për menaxhimin e kostove investuese;
- Një qasje rigoroze për të kontrolluar nivelin e tarifave të FKPK-së.

4.2.2 Udhëzuesi i Politikës së Investimeve (UPI)

UPI do të marrë parasysh një numër kriteresh:

- Nevojën për t'i diversifikuar mjetet efektshëm.
- Kontribuuesit duhet ta kenë dhe mbajnë besimin në institucionin e FKPK-së, e për këtë një politikë e matur investuese është e nënkuptueshme.
- Llogaritë e (dhe detyrimet ndaj) kontribuuesve janë të denominuara në euro, por kjo nuk duhet t'i kufizojë investimet vetëm në instrumente të denominuara në euro.
- Klasat e mjeteve në të cilat FKPK-ja do të investojë do të përfshijnë aksionet, bonot, paranë e gatshme dhe instrumentet e kthimit absolut.
- Politikat investuese do të zbatohen konform moshave të kontribuuesve.
- Politika e Portofolit Konservativ (për kontribuuesit afër moshës së pensionimit) do të ketë investime në asete me risk dukshëm më të ulët.
- Politika e Portofolit Standard (për kontribuuesit e moshës nën 63 vjeçare) do të ketë investime të baraspeshuara mes mundësisë së rritjes së vlerës dhe riskut investues që bartin.
- Nevojën për t'i mbajtur të ulëta kostot operacionale, pa e kompromentuar asnjëherë cilësinë e shërbimeve ndaj kontribuuesve.

4.2.3 Portofoli i tretë investues

Në vitin 2024 synohet që dy portofoleve aktuale t'i shtohet edhe një portofol i tretë, i cili do të jetë i përshtatshëm për kontribuuesit që i afrohen moshës 60-vjeçare, andaj për ta duhet kujdes i shtuar në trajtimin e riskut për investimin e mjeteve pensionale.

Investimet, sipas fondeve investuese ose plasmaneve në Kosovë, për fondin "Standard" më datë 30.09.2023:

Fondi investues / Institucioni	Shuma e investimit	Përqindja e investimit	Klasa e asetit/Strategjia
Vanguard Value ETF	€117,864,149	4.8%	Aksione/Drejtimore
iSh MSCI Eur Value ETF	€86,888,055	3.5%	Aksione/Drejtimore
Lyxor Stoxx Bank ETF	€65,181,489	2.6%	Aksione/Drejtimore
SPDR S&P Oil & Gas ETF	€62,591,432	2.5%	Aksione/Drejtimore
Invesco KBW Bank ETF	€52,658,264	2.1%	Aksione/Drejtimore
SPDR EU Energy ETF	€33,152,185	1.3%	Aksione/Drejtimore
Schroders ISF GSG	€26,045,159	1.1%	Aksione/Drejtimore
BNP Climate Impact	€23,798,772	1.0%	Aksione/Drejtimore
iShare Glb ClnEnergy ETF	€16,481,319	0.7%	Aksione/Drejtimore
Vanguard GSIF	€1,192,005	0.0%	Aksione/Drejtimore
Nordea GSE	€158,829,761	6.4%	Aksione/Risk i menaxhuar
iShare SP500 MinVol ETF	€20,894,952	0.8%	Aksione/Risk i menaxhuar
iShare Core Dividend ETF	€34,673,480	1.4%	Aksione/Të ardhura
SPDR SP Eur Div Aristocrats ETF	€20,401,756	0.8%	Aksione/Të ardhura
GlobalX US Infr ETF	€68,383,385	2.8%	Asete reale/Drejtimore
iShare MSCI Glob Metals Mining ETF	€62,207,403	2.5%	Asete reale/Drejtimore
iShare US Infr ETF	€61,069,211	2.5%	Asete reale/Drejtimore
W.Tree Physical Gold ETF	€36,655,406	1.5%	Asete reale/Drejtimore
W.Tree Crude Oil ETF	€27,913,795	1.1%	Asete reale/Drejtimore
W.Tree Metals ETF	€26,956,613	1.1%	Asete reale/Drejtimore
Nordea SRF	€225,988,485	9.1%	Multi-asete/Risk i menaxhuar
BNY Mellon RRF	€194,574,344	7.9%	Multi-asete/Risk i menaxhuar
Lyxor EUR 10Y Infl ETF	€42,378,474	1.7%	Instrumente borxhi/Risk i menaxhuar
Amundi 3M-I	€493,701,400	19.9%	Tregu i parasë/Të ardhura
Keshi në banka	€70,063,126	2.8%	Tregu i parasë/Të ardhura
Thesari i Kosovës	€325,207,423	13.1%	Instrumente borxhi/Të ardhura
Afatizim bankar në Kosovë	€122,740,830	5.0%	Instrumente borxhi/Të ardhura
GJITHSEJ	€2,478,492,673	100.0%	

Investimet e plasuara në Kosovë për fondin "Konservativ" më 30.09.2023:

Fondi investues / Institucioni	Shuma e investimit	Përqindja e investimit	Lloji i investimit
Keshi në banka në Kosovë	€141,387	0.1%	Kesh/Të ardhura
Thesari i Republikës së Kosovës	€129,163,624	99.9%	Instrumente borxhi/Të ardhura
GJITHSEJ	€129,305,011	100.0%	

4.3 PENSIONIMI I KONTRIBUESVE

Sipas legjislacionit në fuqi, kontribuuesit mund të aplikojnë në FKPK për këto kategori pensionimi:

1) Pension moshe (kur kontribuuesi arrin moshën 65 vjeçare);

2) Pension invaliditeti (në rast të humbjes së përkohshme ose të përhershme të aftësisë për të punuar);

3) Trashëgimia e pensionit (në rastin e vdekjes së kontribuuesit). Ndaras këtyre, legjislacioni iu jep mundësinë të gjithë shtetasve të huaj që kanë kontribuar në FKPK t'i tërheqin mjetet e tyre para arritjes së moshës së pensionimit.

* Me ligj të veçantë, prej 11 dhjetor 2020 e deri më 6 prill 2021, iu është lejuar të gjithë kontribuuesve

e drejta t'i tërheqin para pensionimit 10% të bilancit nga FKPK-ja, si pjesë e masave për rimëkëmbje ekonomike nga COVID-19.

Po sipas ligjit në fjalë, gjatë vitit 2023 Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar me kompensimin e mjeteve të tërhequra nga kjo masë për bilancet deri 9,999 euro për të gjitha llogaritë e pensionuara gjatë periudhës dhjetor 2022 deri më 31 dhjetor 2023. FKPK e ka kryer në kohë kompensimin e këtyre llogarive dhe po ashtu gjatë vitit 2024 pritet të vazhdojë ky proces.

Në vijim paraqesim numrin e kontribuuesve të pensionuar gjatë vitit 2023 sipas muajve dhe shumave të tërhequra.

Numri i kontribuuesve të pensionuar gjatë vitit 2023 sipas muajve dhe shumave të tërhequra

	Numri i të pensionuarve	Shuma e përfituar
Janar	585	€5,025,189
Shkurt	592	€4,846,521
Mars	769	€6,198,012
Prill	690	€5,969,524
Maj	859	€7,054,322
Qershor	610	€5,754,516
Korrik	658	€5,349,358
Gusht	565	€5,606,980
Shtator	610	€5,287,381

Përfituesit e pensionit sipas kategorisë së pensionimit:

	Pension moshe	Pension i trashëguar (raste të vdekjes)	Pension invaliditeti	Shtetas të huaj
Janar	585	80	111	4
Shkurt	420	67	102	3
Mars	600	72	96	1
Prill	547	60	79	4
Maj	688	73	94	4
Qershor	501	50	58	1
Korrik	497	63	95	3
Gusht	444	64	56	1
Shtator	487	70	52	1





5. MIRËBAJTJA E PROCESIVE

FKPK-ja, përmes strukturave vendimmarrëse dhe stafit të saj, i ka përcaktuar synimet zhvillimore kryesore për vitin e ardhshëm. Këto synime gjithsesi shkojnë në drejtim të përmbushjes së misionit të institucionit, por edhe lëvizjes drejt përmbushjes së ambicies dhe arritjes së vlerave të FKPK-së.

Synimet kryesore zhvillimore do të jenë:

- Investimi i mjeteve sipas legjislacionit në fuqi.
- Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme profesionale në fushën e investimeve.
- Mirëmbajtja e shërbimit ndaj klientëve.
- Vazhdimi i ofrimit të shërbimit me standarde të larta për median dhe publikun.
- Përmirësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- Mirëmbajtja dhe avancimi i softuerit për menaxhimin e llogarive (IPSA).

5.1 Njësia për Investime dhe Risk

Njësia e FKPK-së për investime dhe risk ka vazhduar të marrë gjithnjë e më shumë rolin e mbështetësit profesional për vendimmarrjen rreth investimeve të FKPK-së. Kjo u arrit duke e përforcuar këtë njësi me staf të mjaftueshëm dhe kapacitete të tjera të qasjes në rrjetin e industrisë globale financiare.

Raportet, analizat dhe informacionet e thukta të kësaj Njësie, që përpunohen dhe plotësohen nga Menaxhmenti i lartë i FKPK-së, janë themeli i arsytimit për vendimmarrjen e Komisionit të Investimeve të FKPK-së, e rrjedhimisht edhe të vet Bordit Drejtues. Ky rezultat erdhi nga përparimi i kësaj Njësie, nga roli kryesisht raportues në një rol veprues (në kuptimin taktik) dhe këshillëdhënës (në aspektin strategjik). Përmirësimet e vazhdueshme në këtë Njësi e kanë çuar rolin e saj në nivel proaktiv.

5.2 Njësia e Shërbimeve për Klientë

Sipas praktikave më të mira, synimi për shërbim të mirë ndaj klientëve fillon nga vetë stafi i këtij shërbimi. Siç dihet, shërbimi për nga natyra është veprim i cili kryesisht ofrohet prej njerëzve, andaj prania e njerëzve kompetent për t'i kryer shërbimet është parakusht i arritjes së standardeve më të larta. Kompetenca e stafit të shërbimeve për klientë tutje mund të kategorizohet si njohuri teknike dhe inteligjencë emocionale.

Kompetenca teknike, nënkupton njohurinë e thellë të proceseve të punës e shërbimeve të dhëna për klientët. Kjo njohuri duhet të mirëmbahet dhe zhvillohet vazhdimisht përmes trajnimeve dhe komunikimit të brendshëm. Më 2024 planifikohen dy aktivitete (në pranverë dhe vjeshtë) relakuese dhe trajnuese e stafit të shërbimit për klientë të FKPK-së - që e kanë pikërisht këtë qëllim.

Krahas njohurive teknike stafi duhet të posedojë edhe inteligjencën emocionale, një aspekt ky i cili sa vjen e bëhet më i rëndësishëm në komunikim me klientët - ndër të tjera duke e konsideruar edhe moshën e tyre. Përveç këtyretributeve, që duhet t'i gjejë dhe zhvillojë tek stafi, FKPK-ja duhet ta ketë parasysh edhe faktin se stafi për shërbime me klientë duhet të mbahet i motivuar duke i ofruar ambient të mirë pune dhe zhvillim të vazhdueshëm.

5.2.1 Shërbimet për klientë

Krahas mirëmbajtjes së kompetencës dhe zhvillimit apo freskimit të njohurive të stafit në lidhje me shërbimet për klientë, janë të rëndësishme edhe vetë shërbimet e krijuara për klientët.

FKPK-ja mund t'i kategorizojë shërbimet në tri grupe kryesore: pranimi i kontributeve, informimi i kontribuuesve dhe tërheqja e kursimeve. Ofrimi cilësor i secilit prej këtyre grupeve do të mund të quhej shërbim ideal. Këto shërbime janë tashmë të standardizuara, por orientimi kah shërbimet digjitale është gjithnjë e më i synuar dhe i kërkuar.

5.2.2 Pranimi i kontributeve

Përderisa një pjesë e madhe e procesit tanimë është e rregulluar përmes operacioneve të brendshme, megjithatë në mënyrë të vazhdueshme ka sfida në procesin e regjistrimit të duhur të informacionit në lidhje me pranimin e pagesave të kontributeve pensionale të cilat konsistojnë në gabime të pagesave, mosdërgim të listave përkatëse dhe shpërputhje të shumave në mes të vlerës së pagesave dhe shënimeve në listat përcjellëse. Në këtë drejtim, stafi i FKPK-së duhet t'i identifikojë shpejt ngeçjet dhe të nxjerrë propozime të arsyeshme për përmirësimin e këtij procesi, deri në eliminimin e plotë të ngeçjeve.

5.2.3 Informimi i kontribuuesve

Dokumenti kryesor për informimin individual të kontribuuesve është pasqyra e kursimeve pensionale. Për shkak të konsistencës dhe kualitetit të të dhënave, ky dokument tanimë gjen zbatim të madh për kontribuuesit si dëshmi për punët e tyre administrative.

Shpërndarja dhe qasja në pasqyrë do të lehtësohet përmes: (i) vendosjes së një numri unik identifikues në pasqyrë (QR Code), (ii) mundësisë së shkarkimit të pasqyrës nga portali shtetëror eKosova, (iii) zhvillimit të kanaleve digjitale, përmes promovimit të qasjes online për të rritur bazën e përdoruesve të qasjes online dhe promovimit të aplikacionit mobil, (iv) ridizajnimit të portalit eTrusti-t për eksperiencë më të mirë në telefona mobil.

Përkundër se investimet si veprim nuk janë në kompetencën e njësive të shërbimeve me klientë, megjithatë, duke qenë linjë e parë e komunikimit me kontribuuesit, është e rëndësishme që stafi i shërbimeve për klientë të jetë gjithnjë i njoftuar me informatat e fundit dhe trendet më të reja të investimeve; ashtu që të jetë në gjendje që në çdo kohë t'i arsyetojë rezultatet e investimeve në pasqyrat individuale të kontribuuesve.

5.2.4 Shpagimi i kursimeve

Me rastin e tërheqjes së kursimeve pensionale, FKPK-ja vazhdimisht duhet të ofrojë përvojën më të mirë për klientët e vet, posaçërisht për faktin se kryesisht i shërbejmë klientëve më të shtyrë në moshë. Andaj, lehtësimi i procesit të aplikimit duhet të jetë synim i përhershëm. Në këtë drejtim, vazhdueshëm duhet të zëvendësohet pranimi fizik i dokumenteve nga klientët me pranimin elektronik nga institucionet që i lëshojnë ato.

5.3 Njësia e Marrëdhënieve me Publik

Njësia për Marrëdhënie me Publik e FKPK-së, ku kryhen edhe aktivitetet e përkthimit dhe koordinimit të trajnimeve, do të vazhdojë të mbështes institucionin në të gjitha komunikimet dhe raportimet me publikun dhe institucionet mbikëqyrëse.

Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes së FKPK-së, mirëmbajtja dhe përditësimi i llogarisë së FKPK-së në rrjetet sociale (Facebook dhe Instagram), përpilimi i raporteve tremujore, buletinit tremujor, raportit vjetor,

përgjigjja në kërkesat e mediave dhe kërkesave të tjera për informacione dhe të dhëna do të vazhdojnë të jenë angazhimet kryesore të kësaj Njësie. Gjithsesi Njësia duhet të jetë e gatshme t'i përgjigjet të gjitha situatave urgjente, në rast të ngjarjeve të papritura globale që ndikojnë performancën e investimeve të FKPK-së.

5.4 Njësia e Financave dhe Kontabilitetit

Kjo njësi më 2024 do të vazhdojë t'i kryejë të gjitha shërbimet financiare dhe të kontabilitetit, sipas procedurave të brendshme në fuqi dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, por edhe t'i përshtasë proceset me ndryshimet në IPSA, përmes aplikacioneve për ruajtjen dhe realizimin e autorizimeve të brendshme.

5.5 Njësia e Çështjeve Ligjore

Njësia e Çështjeve Ligjore do të synohet të marrë rol edhe më proaktiv në vitin 2024, ku në fokus do të jetë përshtatja, përditësimi dhe harmonizimi i gjithë kornizës së brendshme ligjore (Statutit të FKPK-së dhe dokumentit për Organizimin, Politikat dhe Procedurat e brendshme) me ndryshimet e vazhdueshme në industrinë dinamike ku FKPK-ja operon. Gjithashtu roli këshillëdhënës i kësaj Njësie do të jetë gjithnjë e më i nevojshëm.

5.6 Njësia e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm ka angazhime të rregullta periodike (zakonisht tremujore) të mbikëqyrjes së të gjitha proceseve të brendshme të FKPK-së. Plani i auditimit por edhe raporti përkatës i Njësive të Auditimit shqyrtohet dhe miratohet nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtues i FKPK-së. Kësaj njësie i është shtuar në angazhim tashmë edhe koordinimi i aktiviteteve me auditorin e jashtëm për auditimin e proceseve të teknologjisë së informacionit në FKPK.

5.7 Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Administratës

Kjo njësi pritet t'i realizojë të gjitha kërkesat që lidhen me burimet njerëzore (përfshirë çfarëdo ndryshimi në procedurat e brendshme dhe legjislacionin në fuqi) por edhe të gjitha çështjet administrative (të furnizimit të zyrës me mallra të ndryshme), gjithnjë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe/ose praktikën më të mira.

5. MIRËMBAJTJA E PROCESIVE (VAZHDIM)

5.8 Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

FKPK-ja e njej rëndësinë e pazëvendësueshme të teknologjisë informative dhe të komunikimit, andaj synon të mbajë hapin me arritjet teknologjike, sidomos në fushën e sigurisë së informacionit por edhe të aplikimit të zgjidhjeve efikase.

Në këtë kontekst FKPK-ja ka vënë prioritetet si në vijim:

- Aplikimi dhe konfigurimi i produkteve më të reja në fushën e sigurisë së informacionit;
- Rivlerësimi vjetor i infrastrukturës së TI-së;
- Rritja e efikasitetit në zhvillimin e aplikacioneve të brendshme;
- Rifreskimi i harduerit në baza të rregullta;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e të dhënave të kontribuuesve;
- Testimi i rregullt për rimëkëmbje në rast të fatkeqësive;
- Vëzhgimi i vazhdueshëm për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave në posedim.

Veprimet që do të vihen në funksion për t'i arritur këto objektiva janë përshkruar më poshtë:

5.8.1 Përcjellja dhe implementimi i zhvillimeve më të reja në fushën e sigurisë

Me anë të kësaj strategjie do të synohet të përcillen dhe implementohen zhvillimet e reja në fushën e sigurisë. Përparësitë kryesore të kësaj strategjie janë:

- Zbulimi i shpejtë i ndërhyrjeve (të mundshme) nga jashtë, dhe
- Kontrolli mbi informacionin dhe lëvizjen e tij.

Objektivat kryesore strategjike janë:

- Pjesëmarrja në seminare dhe trajnime;
- Të gjitha zgjidhjet e aplikueshme për FKPK-në, qofshin ato harduerike, softuerike apo konfigurime të ndryshme do të vlerësohen në raportin kosto/përfitim dhe do të zbatohen sipas këtij vlerësimi.

Fokusi kryesor do të jetë në zgjidhjet të cilat zbulojnë dhe parandalojnë qasjet e paautorizuara në rrjetin e FKPK-së, zbulojnë dhe izolojnë viruset e ndryshme kompjuterike, ofrojnë kontroll të mjaftueshëm mbi rrjedhjen e informacionit.

5.8.2 Rivlerësimi vjetor i infrastrukturës serverike

Kjo strategji do t'i mundësojë FKPK-së që të bëjë optimizimin e infrastrukturës duke reduktuar numrin e serverëve fizikë dhe virtualë me anë të konsolidimit të tyre.

Përparësitë kryesore janë: a) Puna e një serveri do të optimizohet deri në atë masë sa të arrihet të shfrytëzohet kapaciteti i tij maksimal, b) Thjeshtimi i mirëmbajtjes së serverëve duke zvogëluar (njëkohësisht) edhe kohën e shpenzuar për ta, c) Replikimi më i shpejtë në qendrën për rimëkëmbje.

Objektivat kryesore strategjike janë:

- Monitorimi i shërbimeve që aktualisht janë të implementuara nëpër serverë për të parë resurset të cilat u nevojiten, b) Rigrupimi i shërbimeve në serverë për të shfrytëzuar maksimumin e kapacitetit të serverëve pa e degraduar performancën.

5.8.3 Konsolidimi i teknologjive të përdorura për zhvillimin e aplikacioneve

Me kalimin e kohës edhe aplikacionet ndihmëse të zhvilluara brenda FKPK-së, e po ashtu edhe aplikacionet më të komplikuar, të cilat mund të jenë të zhvilluara brenda apo edhe të kontraktuara, fillojnë të kërkojnë më shumë kohë për mirëmbajtjen dhe operimin e tyre.

Përparësitë kryesore janë: a) Unifikimi i teknologjisë së përdorur për zhvillimin e aplikacioneve; b) Unifikimi i natyrës së aplikacioneve; c) Unifikimi i mënyrës së dizajnit të aplikacioneve me qëllim të lehtësimit të mirëmbajtjes dhe modifikimit të tyre në të ardhmen; d) Zhvillimi më i shpejtë dhe i saktë i aplikacioneve; e) Shpërndarja më e lehtë e aplikacioneve deri te përdoruesi.

Objektivat e synuar do të jenë vlerësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme (në pikëpamje të burimeve njerëzore) dhe plotësimi me trajnime dhe konsulencë, apo edhe me staf të nevojshëm.

5.8.4 Aplikimi i një cikli të rregullt për ndërrim të harduerve sipas kategorive

Për të siguruar operim të vazhdueshëm, FKPK-ja do të planifikojë dhe të ndërrojë me kohë pajisjet harduerike me të cilat operojnë zyrtarët e FKPK-së.

Përparësitë kryesore të këtij veprimi janë: a) Shmangia nga mundësia e dështimit të harduerit, b) Rritja e mundësisë për aplikim të teknologjive të reja të cilat kërkojnë hardduer më të ri. Objektivat e synuara janë: a) Vlerësim dhe rishpërndarje e harduerit aktual, b) Përcaktimi mbi ciklin se kur do të bëhen ndërrimet. Grupet e ndryshme harduerike do të kenë edhe cikël të ndryshëm të ndërrimit, varësisht nga jetëgjatësia e tyre.

5.9 Mirëmbajtja e IPSA

Bazuar në studimin e fizibilitetit në lidhje me zhvillimin përbrenda të sistemit kryesor për menaxhimin e llogarive pensionale, ku jepet një pasqyrë e qartë mbi përfitimet që FKPK-ja do t'i ketë me këtë qasje, Bordi Drejtues kishte vendosur që nga prilli 2020 të fillonte zhvillimi i sistemit të ri (IPSA) për menaxhimin e llogarive pensionale nga vetë stafi vetanak i FKPK-së. Përparësitë, në të cilat shpreson FKPK-ja, janë kosto më e ulët e mirëmbajtjes, reagim më i shpejtë në raste të nevojës për intervenim, dhe zhvillim shumë më i shpejtë i funksionalitetit të ri, për të cilin do të ketë vazhdimisht nevojë.

Sistemi IPSA, pasi u funksionalizua sipas planit të zhvillimit, më 2024 do të vazhdojë tutje me mirëmbajtje, përmirësim e plotësim sipas nevojave të institucionit. Deri më tani ky sistem i është përgjigjur, sipas pritshmërive, të gjitha nevojave dhe kërkesave për ndryshim. IPSA është e përbërë prej një sërë modulesh, të cilët tashmë janë funksionalizuar dhe operojnë suksesshëm, pa asnjë vështirësi domethënëse. Ndërsa për vitin e ardhshëm ngelet pasurimi i këtij sistemi me module shtesë, sipas nevojave të FKPK-së.





6. MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT 2024

Nr	AKTIVITETI	MUAJT											
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1.	Pranimi/barazimi i kontributeve pensionale												
2.	Kthimi në ATK i mjeteve të pabarazuara												
3.	Investimi/tërheqja e mjeteve pensionale të investuara												
4.	Pagesa mujore e pensioneve												
5.	Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të llogarive (IPSA)												
6.	Vlerësimi dhe analizat e investimeve nga Bordi												
7.	Shërbimi për klientë në distancë (eTrusti, uebfaqja, e-mail, telefon)												
8.	Analiza për portofolin investues shtesë												
9.	Publikimi i raporteve tremujore (BQK, Kuvend, ueb)												
10.	Mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues												
11.	Përgatitja e Raportit Vjetor 2023 dhe dërgimi në Kuvend												
12.	Konferenca vjetore për medie												
13.	Testimi vjetor i planit për rimëkëmbje në rast fatkeqësie												
14.	Rishikimi i buxhetit vjetor												
15.	Përgatitja e tarifave vjetore dhe buxhetit si dhe dërgimi në Kuvend												
16.	Auditimi i pasqyrave financiare nga Auditori i Jashtëm												
17.	Inspektimi vjetor nga BQK-ja												
18.	Auditimi i teknologjisë së informacionit												
19.	Rimbursimi i kontribuuesve nga tërheqja e 10%-shit												

7. PROJEKSIONI DHE PLANI I TË HYRAVE PËR VITIN 2024

Veprimtaritë e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës financohen duke iu ngarkuar llogarive individuale të kontribuuesve në skemën e kursimeve pensionale tarifa të arsyeshme të bazuara në shpenzimet për investimin e mjeteve pensionale dhe shpenzimet për operim të zyrës së FKPK-së.

Sipas Nenit 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101: "Kuvendi i Kosovës cakton tarifën investuese dhe operacionale në bazë të kërkesës së FKPK-së për çdo vit kalendarik. Kërkesa duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përlllogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa". Sipas Nenit 4.15 dhe Nenit 5.2 paragrafi j) të Ligjit Nr. 04/L-101, Bordi Drejtues gëzon të drejtën për të miratuar buxhetin e FKPK-së, dhe bazuar në këtë të drejtë e ka miratuar buxhetin për vitin 2024.

Buxheti i miratuar nga Bordi Drejtues për aktivitetet operacionale për vitin 2024 është projektuar në 1,332,000 EUR ose për 41,605 EUR më i lartë sesa buxheti për vitin 2023 (2023 ishte: 1,290,395 EUR). Taksa operacionale për vitin 2024 është propozuar të jetë me normën 0.048% e mjeteve, një ulje kjo nga norma aktuale prej 0.050%.

Ndërsa buxheti i miratuar për aktivitetet investuese për vitin 2023, pra shpenzimet që ndërlidhen me investimin e mjeteve pensionale, do të financohet duke ngarkuar tarifën prej 0.31% mbi mjetet nën menaxhim. Në vlerë nominale kjo tarifë pritet të sjell të hyra prej 8,227,619 EUR (2023: 8,227,619 EUR) ose një rritje prej 804,654 EUR nga viti paraprak.

Niveli i tarifave të propozuara, për financimin e shpenzimeve operacionale dhe investuese të FKPK-së, ndër të tjera, varet edhe nga kontributet e reja, tërheqjet e kursimeve (p.sh. nga pensionimi i kontribuuesve), gjegjësisht nga mjetet që do t'i ketë FKPK-ja nën menaxhim gjatë vitit.

Kështu, nga vlerësimet e bëra, pritet për vitin 2024 janë:

- Viti të fillojë me 2,665 milionë EUR MNM.
- Kontributet e arkëtuara të jenë 300 milionë EUR.
- Tërheqja e kursimeve të jetë 60 mln EUR.
- Viti të përfundojë me 2,895 mln EUR MNM.
- Mesatarja e MNM të jetë rreth 2,775 milionë EUR.

7.1 Tarifa investuese

Vlerësimi i shpenzimeve investuese varet kryesisht nga alokimi i pritshëm i mjeteve nëpër fondet investuese për vitin 2024, si dhe kostot që i ngarkojnë menaxhuesit e këtyre fondeve. Bazuar në këto dy elemente, si dhe shpenzimet e pritshme për transferet ndërkombëtare dhe kujdestarinë e mjeteve, mesatarja e ponderuar e shpenzimeve investuese pritet të jetë rreth 0.31% e mjeteve mesatare përgjatë vitit. Kjo tarifë është lehtësisht më e ulët sesa vitin paraprak.

7.2 Tarifa operacionale

Bazuar në parashikimet për mjetet në menaxhim, me ngarkimin e tarifës operacionale prej 0.048% mbi mjetet pensionale FKPK-ja do t'i arkëtonte gjithsej 1,332,000 EUR, sa është edhe vlera e parashikuar e buxhetit operacional për vitin 2024.

7.3 Rekomandimi për Kuvendin

Duke u bazuar në shpjegimet e mësipërme, Bordi Drejtues i FKPK-së i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i miratojë për vitin 2024:

1. Tarifën investuese vjetore prej 0.31% të mjeteve;
2. Tarifën operacionale vjetore prej 0.048% të mjeteve.

Sipas këtij rekomandimi, gjithsej tarifat e ngarkuara mbi mjetet pensionale do të ulëshin nga 0.370% sa janë aktualisht, në 0.358% të mjeteve – pra, në nivelin më të ulët që nga themelimi.

